

## 7. Ripërteritja urbane e nje Blloku banimi ne Lagjen “28 Nentori”

Matrica permbledhese e projektit

Titulli i Projektit	Ripërteritja urbane e nje Blloku banimi ne Lagjen “28 Nentori”
Fusha prioritare	Kultura, Mjedisi & Zhvillimi Social, Zhvillimi urban.
Qellimi	Per te ngritur cilesine e jetes ne zemren urbane te qytetit me nje infrastrukture bashkekohore perreth nje ambjenti kulturor dhe sportiv.
Objektivat	<ul style="list-style-type: none"><li>○ Per te krijuar dhe zbatuar nje program per rivitalizimin e lagjes duke shfrytezuar nje njesi banimi perfaqesuese te ndertuar.</li><li>○ Per te rindertuar rruget, fasadat e godinave, sistemin e ujesjelles-kanalizimeve dhe ndricimin.</li><li>○ Per te percaktuar dhe ndertuar zonat e grumbullimit te plehrave dhe hapesirat e gjelbra.</li></ul>
Perfituesit	
Zbatuesit	
Partnere lokale	Perfaqesues te bashkepronësive private te banoreve te zones, biznese egzistuese aktive ne zone si dhe OJF te ndryshme ne qytet.
Koha e zbatimit te projektit	24 muaj
Buxheti	<b>55,750,000</b> leke, 541,260 USD, 457,000 Euro
Menyra e financimit	Bashkefinansim Banka Boterore 50%, Bashkise se Elbasanit 30% dhe Qeveria Qendrore 20%(TVSH-ja)

## **Pershkrimi i pergjithshem:**

Ky projekt parashikon identifikimin e nje zone njesi te ndertuar banimi, qe i perket viteve 1970 kur ne Elbasan kishte nje rritje ekonomike dhe mjaft ndertime masive, dhe krijimin e nje perpjekje pilot per riperceritjen te zones. Njesi/zona ne shqyrtim per projektin ne fjale eshte blloku i banimit ne perendim te Pallatit te Sportit "Tomorr Sinani", e vendosur ne zemer te qytetit, shume prane qendres kulturore, historike dhe sportive te tij.

Ne pjesen veriore te ketij blloku ndodhet pallati 422 me dy seksione me nje disnivel te theksuar terreni ne krahasim me ndertimet ne pjesen jugore.

Ne pjesen perendimore te bllokut ndodhen tre kulla 6 kateshe dhe nje banese tjeter kolektive 5 kateshe duke konturuar keshtu bllokun e banimit.

Ne pjesen lindore te bllokut ndodhet Pallati i Sportit i cili sot eshte ne gjendje teper te amortizuar me gjithë terrenet e tij funksionale perreth.

Ne brendesi te ketij blloku banimi shtrihet nje aks rrugor kuadratik i cili rrethon nga te kater anet ne forme unaze te brendeshme kete bllok.

Infrastruktura rrugore e zones le shume per te deshruar pasi ka shume vite qe ne kete zone nuk jane kryer investime me qellim mirembajtje,

Territoret e gjelbera te zones sidomos ne brendesi te bllokut, prane grupit te pallateve megjithese hapesirat publike ne kete zone jane te bollshme jane zhdukur krejtesisht duke ia lene vendin baltes dhe hedhjes ne menyre te pakontrolluar mbetjeve urbane.

Vihen re probleme te theksuara te infrastruktures nentokesore si dhe mungon totalisht ndriçimi publik, jane te amortizuar gjithashtu kanalizimet, linja e ujesjellesit.

**Pershkrimi i projektit:** Projekti parashikon nje rikonstruksion te plote te infrastruktures rrugore perreth, duke perfshire ketu dhe shtrimin e trotuareve ne segmentet ku gjeresia e rruges e lejon. Siperfaqja totale e rrugëve dhe trotuareve eshte rreth 3 900 m<sup>2</sup>.

Shtrimin e rrjetit nentokesor te ndriçimit per t'a zevendesuar ate me rrjetin egzistues ajror, rikonstruksionin e sistemit egzistues te drenazhimit te ujerave te shiut dhe ne vendet ku nuk ka shtrimin e K.U.B. dhe K.U.Z.

Ne kete projekt parashikohet vendosja e ndriçueseve ne te gjithë bllokun, per te permiresuar cilesine e sherbimeve te zones.

Rikompozimi i lulishteve egzistuese me sip. totale rreth 2 950 m<sup>2</sup> per t'i kthyer ato te frekuentueshme nga te gjithë, vendosja ne to e stolave dekorative, e ndriçuesve dekorative, e minikoshave te pleherave, e pasurimit te fondit te gjelber, etj.

Gjithashtu ne kete projekt parashikohet rikonstruksioni i fasadave te objekteve shumekateshe perreth me material bashkekohor dhe termoizolues, me qellim vleresimin e tyre per te nxjerre ne pah vlerat e periudhes qe ato perfaqesojne dhe qe shenojne nje epoke te veçante ne zhvillimin urban te qytetit. Siperfaqja totale e tyre eshte rreth 5 900 m<sup>2</sup>.

Restaurimi i fasades se Pallatit te Sportit "T. Sinani" ne harmoni me objektet perreth me nje siperfaqe totale rreth 2 600 m<sup>2</sup>.

## **Fazat neper te cila kalon realizimi i projektit:**

**Faza e pare.** Eshte faza e hartimit te projektit teknik te permiresimit te infrastruktures rrugore egzistuese si dhe te ndertimit te infrastruktures se nevojshme nentokesore si Ujesjelles, K.U.Z., K.U.B., rrjetin elektrik, telefonik, etj. Ky projekt do te realizohet konform detyrave te lena ne studimin urbanistik te qendres se qytetit Elbasan.

Zbatimi i tij do te financohet nga Bashkia, Banka Boterore dhe Qeveria Shqiptare.

**Faza e dyte.** Permiresime ne siperfaqen e gjelber perreth ku si faze e pare do te perfshihen aktivitetet si mbjellje pemesh dhe rrethimi i tyre me kangjella dekorative.

Ne kete faze do te realizohen negociatat me bizneset e zones e me gjere per implementimin e ketij projekti me financimin e tyre ne bashkepunim me bashkine per restaurimin e banesave te tyre.

**Faza e Trete.** Restaurimin e te gjitha fasadave te pallateve perreth dhe te vete Pallatit te Sportit, me material termoizolues te granular.

Ketu do te investojne Bashkia, Banka Boterore, ne bashkepunim me iniciativat private te qytetareve dhe te bizneseve te zones.

**Faza e katert.** Restaurimin e te gjitha infrastruktures nentokesore si: K.U.B., K.U.Z., rrjetin e ujesjellesit, shtrimin e rrjetit elektrik dhe telefonik nentokesor ne bashkepunim me ndermarrjet respektive pergjegjese. Ndertimin e rrugeve dhe trotuareve duke perfshire ketu vendosjen e shtyllave te ndricimit publik te zones.

#### **Nderhyrje konkrete per realizimin e projektit:**

1. Hartimi i projektit teknik te zbatimit te permiresimit te infrastruktures rrugore dhe inxhinierike, lulishteve dhe rikonstruksionit te fasadave.
2. Rikonstruksioni i rrjetit elektrik nentokesor
3. Rikonstruksioni i rrjetit telefonik nentokesor
4. Rikonstruksioni i rrjetit te ujesjellesit
5. Rikonstruksioni i KUZ dhe KUB
6. Rikonstruksioni i rrugeve perimetrare te bllokut.
7. Ndrichimi publik i te gjitha zones
8. Rikonstruksioni i lulishteve perreh sipas standarteve bashkekohore
9. Rikonstruksioni i fasadave te pallateve dhe te pallatit te sportit

#### **Kosto e projektit:**

- Hartimi i projektit te zbatimit	750 000 leke
- Rikonstruksioni i rrjetit inxhinierik nentokesor	9 000 000 leke
- Rikonstruksioni i rrugeve, trotuareve dhe ndrighimi publik	18 000 000 leke
- Rikonstruksioni total i fasadave	20 000 000 leke
- Rikonstruksioni i lulishteve ne total	8 000 000 leke

Vlera totale e hartimit dhe zbatimit te projektit eshte **55 750 000 leke**

**Impakti ne Komunitet:** Ky projekt do te sjelle perfitim per qytetaret te cilet shfrytezojne kete mjedis. Krijimi i ambjenteve shlodhese dhe te bukura perreth ketij objekti te rendesishem kulturor e sportiv do te sillte perfitim jo vetem tek banoret e zones por dhe tek

i gjithë qyteti, pasi ky bllok banimi frekuentohet pothuajse nga të gjithë për vetë pozicionimin e tij në qendër të qytetit.

**Realizimi i Projektit:** Projekti do të zbatohet nga Bashkia Elbasan, për të cilin mund të punohet bashkë me banorët e zonës dhe donatorë të ndryshëm.

**Partnere:** Perfaqësues të bashkepronesive private të banorëve të zonës, biznese egzistuese aktive në zonë si dhe OJF të ndryshme në qytet.

### Kalendari i Aktiviteteve:

Nr	Aktivitetet/Periudha	Viti 2006		Viti 2007		Viti 2008	
1	Hartimi i projektit teknik të zbatimit të përmirësimit të infrastrukturës rrugore dhe inxhinierike, lulishteve dhe rikonstruksionit të fasadave.						
2	Rikonstruksioni i rrjetit elektrik nëntokësor						
3	Rikonstruksioni i rrjetit telefonik nëntokësor						
4	Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjetësor						
5	Rikonstruksioni i KUZ dhe KUB						
6	Rikonstruksioni i rrugëve, trotuareve, ndriçimit publik						
7	Rikonstruksioni i fasadave të pallateve dhe të pallatit të sportit						
8	Rikonstruksioni i lulishteve në këto zona						